



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	16.04.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHRPSHC	1835/2021		113

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr. 118/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.118/2021, të datës 03.03.2021, të ankuesit me adresë banimi fshati “Balincë”, nga Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike “transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.118/2020 e datës 03.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

**II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 02/456 i datës 16.02.2021 i Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

**III. OBLIGOHET** Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesin ta kthejë në pozitën “Nëpunës administrativ në Qendrën Kryesore të Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë” sipas Akt emërimit me numër Nr.ref: DRAPSHC/ARC/03/2013 të datës 22.08.2013.

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas Akt emërimit me numër Nr.ref: DRAPSHC/ARC/03/2013 të datës 22.08.2013 në pozitën e punës „Nëpunës Administrativ pranë Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë” Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës, me datën 16.02.2021 Ushtruesi i

detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, ka nxjerr vendim me numër 02/456, me të cilin nëpunësin e ka transferuar për kohësisht nga pozita e Nëpunësit administrativ në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë në pozitën e punës Nëpunës Administrativ në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Klinë.



Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 02/456 të datës 16.02.2021 të Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, me datën 03.03.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 929/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi për transferim i datës 16.02.2021 është bere në kundërshtim me rregulloren QRK nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve civil dhe Ligjin 06/L-114 për Zyrtares Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datën 08.03.2021 me numër protokollit 1050/2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 12.03.2021 me numër protokollit 1114/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër A.nr.118/2021, e datës 03.03.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër 02/456 i datës 16.02.2021 i ushtruesit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil; Vendim me numër RLN nr.1.08/2021 i Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i krimeve të rënda; Akt emërim i ankuesit me numër Nr.ref:DRAPSH/ARC 03/2013 i datës 22.08.2013; Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 08.03.2021; Përgjigja në ankese e datës 12.03.2021 me shkresat e bashkangjitura; E-maili zyrtar i datës 12.02.2021; E-maili zyrtar i datës 12.02.2021; E-maili zyrtar i datës 12.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me atë se transferimi është bërë në kundërshtim me Ligjin 06/L-114 për Zyrtares Publikë, dhe pas analizimit të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimi ka konstatuar se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm, sepse Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil-Ministria e Punëve të Brendshme, ka nxjerr Vendim me numër 02/456, i datës 16.02.2021, me të cilin ankuesin e ka transferuar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114, për Zyrtares Publik, ku përcaktohet se: **“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtë kategori, në këto raste:1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve;1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve”**, sepse në rastin konkret Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, nuk e ka përcaktuar saktë periudhën kohore se sa do të zgjasë transferimi i nëpunësit civil por e ka sistemuar përkohësisht në interes të institucionit nga Qendra e Automjeteve në Malishevë në Qendrën e Automjeteve në Klinë, e qe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi me numër 02/456 i datës 16.02.2021, i Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e ankuesit është nxjerr nga organi jo kompetent dhe si i tille është në kundërshtim me nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku theksohet se: **2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimi nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”**, sepse në rastin konkret Vendimi për transferim i ankuesit





është dashur të nxjerrët nga Njësia Përgjegjëse respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi me numër 02/456, i datës 16.02.2021 i Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil-Ministria e Punëve të Brendshme për transferimin e ankuesit nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Klinë, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji në mënyrë unanime vendosi të aprovoje ankesën e ankuesit si të bazuar, të anuloi Vendimin me numër 02/456 të datës 16.02.2021 të Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, lidhur me transferimin e ankuesit Besart Gashi, dhe obligoje Ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil,, që ankuesin ta kthej në pozitën e tij të punës, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

### Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A.nr.118/2021

Ardita Percuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së